



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:008061  
Datë: 30.04.2024  
Numri i dokumentit: 05642563

**PA1.nr.485/23**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS** – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Abdullah Ahmeti - kryetar i kolegjit, Skender Çoçaj dhe Zyhdi Haziri, anëtarë, me pjesëmarrjen e praktikantes gjyqësore Gentijana Manaj-Gashi si procesmbajtëse, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.N, nga Vitia, për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor , nga neni 186 par.1 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal, P.nr.61/23 i datës 02.02.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur, me datë 22.04.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan-Dega në Viti, P.nr.61/23 i datës 02.02.2023, **vërtetohet**.

**A r s y e t i m i**

Gjykata Themelore në Gjilan-Dega në Viti, me aktgjykimin, P.nr.61/23 i datës 02.02.2023, të akuzuarin e ka shpallur fajtor për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor , nga neni 186 par.1 të KPRK-së dhe e ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, ashtu që dënimi i shqiptuar do të ekzekutohet në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm. Duke u bazuar në nenin 44 të KPRK-së dhe me pëlqimin e të dënuarit, gjykata ka vendosur që dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, të njëjtin t'i zëvendësohet me dënim me gjobë në shumë prej 800 (tetëqind) euro, të cilin dënim i pandehuri do t'a paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita kur aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm. Nëse i pandehuri i lartcekur nuk dëshiron ose nuk mund t'a paguaj gjobën, atëherë gjykata do t'ia zëvendëson dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që 1 (një ) ditë burgim

do të barazohet me 20 (njëzet) euro të dënimit me gjobë. Koha e kaluar në paraburgim nga data 11.01.2023 deri me datë 31.01.2023, i llogaritet në dënimin e shqiptuar me gjobë, ashtu që 1 (një) ditë të qëndrimit në paraburgim do të zëvendësohet me 20 (njëzetë) euro të dënimit me gjobë. Obligohet i pandehuri që të paguaj në emër të paushallit gjyqësorë shumë prej 20 (njëzet) euro si dhe shumë prej 20 (njëzet) euro në emër të fondit për mbrojtjen e viktimave të krimit, të gjitha këto brenda afatit prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur:

Prokuroria Themelore në Gjilan PP.II.nr.90/2023 i dt.13.03.2023, për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, me propozim që Gjykata e Apelit të Kosovës, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që ndaj të akuzuarit A.N, për veprën penale të lartpërmendur, për të cilën është shpallur fajtor t'i shqiptoi dënim më të lartë, konform dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit A.N, av.XH.H duke kundërshtuar në tërësi ankesën e ushtruar nga Prokuroria Themelore në Gjilan, me propozim që Gjykata e Apelit të refuzoj si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe të vërtetoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ose eventualisht të zbus dënimin e shqiptuar.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.524/23 të datës 14.04.2023, ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan, ku i njëjti aktgjykim i ankimuar të ndryshohet sa i përket vendimit lidhur me dënimin , në atë mënyrë që të akuzuarit A.N, për shkak të veprës penale Lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.1 të KPRK-së, për të cilin fajësohet, t'i shqiptohet dënim më i ashpër.

Gjykata e Apelit e Kosovës, pasi që shqyrtoi të gjitha shkresat e kësaj çështje juridike penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitën e nenit 394 të KPP-së, dhe pasi vlerësoi pretendimet e cekura në ankesë, gjeti se:

**-Ankesa nuk është e bazuar.**

Prokuroria Themelore në Gjilan PP.II.nr.90/2023 i dt.13.03.2023 e ankimon aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, për shkak vendimit lidhur me sanksionin penal me pretendimin se gjykata e shkallës së parë të akuzuarit nuk i ka shqiptuar dënimin e merituar në pajtim me ligjin, sepse sanksioni –dënimi i shqiptuar është në kundërshtim me rregullat e përgjithshme mbi matjen dhe caktimin e dënimit të përcaktuar me nenin 69,70,71 dhe 72 të KPRK-së. Prokuroria Themelore në Gjilan pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk i ka marrë dare parasysh rrethanat rënduese sepse vetëm sikur të kishte parasysh se motivin që i ka paraprirë veprës penale që e ka qenë ushtrimi i pushtetit dhe kontrollit, cenimi i dinjitetit të dëmtuarit përmes dhunës psikike, e sidomos faktin se vepra penale është kryer me dashje direkte, madje kryesi ka treguar këmbëngulësi duke dashur të tregohet i pushtetshëm para vëllaut të tij dhe të mbajë në kontroll, duke ushtruar edhe dhunë fizike e po ashtu edhe psikologjike, pasoja e shkaktuar dhe shqetësimin

e madh emocional që ka përjetuar i dëmtuari, e që mund të lë pasoja të pariparueshme emocionale tek i njëjti, andaj konsideron se gjykata nuk i ka vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat dhe me këtë edhe i ka minimizuar veprimet inkriminuese të akuzuarit në masë të madhe, sidomos kur kemi parasysh faktin se veprat e tilla janë në rritje e sipër dhe një dënim i tillë nuk do ti kontribuonte parandalimit, nuk shpreh satisfaksion për viktimat e as gjykimin shoqëror për veprat penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. I propozon Gjykatës e Apelit të Kosovës, aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj sa i përket vendimit mbi dënimin, ashtu që ndaj të akuzuarit A.N, për veprën penale të lartpërmendur, për të cilën është shpallur fajtor t'i shqiptoi dënim më të lartë, konform dispozitave të Kodit Penal të Republikës së Kosovës.

Përgjigje në ankesë ka parashtruar mbrojtësi i të akuzuarit A.N, av.XH.H, i cili kundërshton në tërësi ankesën e ushtruar nga Prokuroria Themelore në Gjilan duke pretenduar se nuk qëndrojnë pretendimet nga ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjilan pasi që Gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar një dënim të lehtë, pasi që nëse shiqohet rrjedha e procedurës në këtë lëndë shifet se procedura kontestimore end nuk ka përfunduar në gjykatë pasi që i pandehuri jeton në katin e dytë. I dëmtuari A.N, në ditën kritike pas një mosmarrëveshje verbale lidhur me dëmtimin e tëpësisë të korridorit ka sulmuar të pandehurin vëllaun A.N duke e goditur me boksa dore dhe i shkakton lëndime trupore. Konsideron se Prokuroria Themelore në Gjilan i ka nënvlerësuar rrethanat lehtësuese. Duke pas parasysh praktikën gjyqësore të ndëshkimeve për këso vepra penale , konsideron se dënimi që i është shqiptuar është ligjore dhe se nuk ka arsye që i njëjti të ashpërsohet. I propozon Gjykatës e Apelit që të refuzoj si të pabazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe të vërtetoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ose eventualisht të zbus dënimin e shqiptuar.

Gjykata e Apelit e Kosovës, vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Gjilan, që të akuzuarit ti shqiptohet dënim më i rënd, nuk janë të bazuara. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme e cila do ta arsyetonte shqiptimin e dënimi më të rëndë, për të akuzuarin. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se gjykata e shkallës së parë, gjatë matjes së shqiptimit të dënimit pati parasysh të gjitha rrethanat e rastit konkret, ku si rrethana posaçërisht lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë në një fazë të hershme të procedurës penale. gjendjen e varfër ekonomike, i papunë, është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tij, faktin se i njëjti ka premtuar që në të ardhmen nuk do të kryejë vepra të tilla dhe as vepra të tjera penale, i ka kërkuar falje vëllait të tij A.N, është mbajtës i familjes 3 (tre ) anëtarëshe, me punë jo të rregullt, ndërsa si rrethana rënduese gjykata mori parasysh faktin se kjo vepër penale është kryer ndërmjet anëtarëve të familjes, në shtëpinë e përbashkët dhe me veprimet e të pandehurit tek A.N janë shkaktuar lëndime të rënda trupore andaj edhe mbi të lartcekurat gjykata konsideron se dënimi i shqiptuar ndaj të pandehurit të lartcekur duke i marrë parasysh rrethanat e përmendura si më lartë është dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Një vlerësim të këtillë të rrethanave relevante për matjen e dënimit si të drejtë dhe të ligjshëm e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë i ka vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa pretendimet e Prokurorisë Themelore në Gjiilan, nuk kanë ndikim që të akuzuarit ti shqiptoj dënim më të rëndë. Të gjitha këto rrethana e sidomos duke i marr parasysh pranimin e fajësisë së të akuzuarit, gjendjen e varfër ekonomike, është i martuar baba i një fëmiju sipas vlerësimit të kolegjit penal të kësaj gjykate japin bazë të mjaftueshme që arsyetojnë shqiptimin e dënimit nga gjykata e shkallës së parë si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar, andaj duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe drejtë të vlerësuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, del se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarit është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer, me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe se kjo do t'i shërbej preventivës gjenerale, posaçërisht asaj individuale, forcimit të moralit të shoqërisë, si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me këtë kryerësit do të parandalohen nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të bëhet rehabilitimi i tyre. Andaj kolegji penal i kësaj gjykate konsideron se dënimi i shqiptuar është i mjaftueshëm për tu arritur qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 38 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**PA1.nr.485/23, më datë 22.04.2024**

**Procesmbajtësja,**  
Gentijana Manaj-Gashi

---

**Anëtarët e kolegjit:**  
Skender Çoçaj

---

**Kryetar i kolegjit,**  
Abdullah Ahmeti

---

Zyhdi Haziri

---